

Monika KRYEMADHI



Datëlindja: 09.04.1974

Vendlindja: Tiranë

Email: Monika.Kryemadhi@parlament.al

Jetëshkrimi:

Kryemadhi është diplomuar në degën Bio-Kimi në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Gjatë periudhës Gusht 1999 – Dhjetor 1999 ka kryer studime mbi sigurinë rajonale në ” George C Marshall European Center for Security Studies, Gjermani.

Ndërkohë në vitin 2000–2002 ka kryer Master në “Administrim Biznesi”, në Fakultetin Ekonomik të Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Universitetin e Nebraskës. Në prill të vitit 2002 ka marrë “Certificate of Appreciation” nga Qendra George C. Marshall. Njëkohësisht në prill 2002 ka mbaruar “Leadership for the 21 st Century: Chaos, Conflict and Courage” në Harvard University.

Gjithashtu në vitin 2015 ka përfunduar Doktoraturën për “Analiza e Sistemit të Sigurimeve Shoqërore në Këndvështrimin Ekonomik dhe Juridik.

Angazhimi i saj politik ka filluar që në vitin 1991, ku ajo ishte një nga themeluesit e FRESSH. Në janar të vitit 1992 u zgjodh anëtare e Kryesisë dhe në maj të po atij viti, ajo u zgjodh Sekretare e Përgjithshme e FRESSH-it në Kongresin e I dhe II. Ajo mbajti funksionin Presidente e FRESSH deri në prill të vitit 2002.

Nga viti 1995 deri 2000 ajo u zgjodh nënkryetare e Socialist International Youth IUSY.

Ka qenë anëtare e Partisë Socialiste nga dhjetori 1991 deri në shtator të vitit 2004. Gjatë kësaj kohe ajo ishte gjithashtu anëtare e Kuvendit të Shqipërisë nga viti 2001 deri 2005, si edhe u zgjodh dy herë për Këshillin Bashkiak të Tiranës për të cilin ajo është zgjedhur Sekretare e Delegacionit të Qeverisë Lokale në Këshillin e Evropës. Në shtator të vitit 2004, ajo ishte një nga themeluesit e Partisë Socialiste për Integrim (LSI). Gjatë periudhës 2005-2013 ka mbajtur pozicionin e Sekretares Organizative në Lëvizjen Socialiste për Integrim. Më 5 korrik 2017, Kryemadhi u zgjodh kryetarja e re e Lëvizjes Socialiste për Integrim.

